



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0269

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE “Eng Idea SH.P.K.”, kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi dhe Revidimi i Projekteve Kapitale” me numër të prokurimit 624-25-1794-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, më 12/06/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e “Eng Idea SH.P.K.” me nr. 2025/0269, e datës 14/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi dhe Revidimi i Projekteve Kapitale”, me numër të prokurimit 624-25-1794-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.
2. Vërtetohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit të lartëshenuar sipas pikës I të dispozitivit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna Suharekë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 14.03.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi dhe Revidimi i Projekteve Kapitale”, me numër të prokurimit 624-25-1794-2-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për shërbime, kriteri dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët i peshuar (poentuar), vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00€.

Me datën 01.04.2025, OE “Eng Idea SH.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin për kontratë të Autoritetit Kontraktues. AK me datën 04.04.2025 ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim të OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 14.04.2025 operatori “Eng Idea SH.P.K.” ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0269 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 15.05.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- AK të bëjë përmisimet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “Eng Idea SH.P.K.”

Përgjigja I: Kërkesa për inxhinier të arkitekturës të certifikuar për përdorimin e AutoCAD është një kërkesë e justifikueshme dhe e arsyeshme për disa arsye: AutoCAD është një softuer i njohur dhe i përdorur gjerësisht në industrinë e projektimit të projekteve kapitale, përfshirë projektimin arkitektonik, konstruktiv, elektrik, hidraulik etj. Shumica e projekteve ekzistuese janë të punuara dhe të arkivuara në format të përshtatshme me AutoCAD, kështu që përdorimi i këtij softueri siguron integrimin e duhur dhe përputhshmërinë e të dhënave ndërmjet AK-së dhe operatoreve ekonomikë. Për shembull, ndryshimet e mundshme gjatë fazës së zbatimit të projektit mund të kryhen shpejt dhe me saktësi vetëm nëse të gjitha palët punojnë me të njëjtin format të të dhënave. AK nuk përjashton përdorimin e softuerëve të tjerë të njohur si ArchiCAD, Revit, 3Ds MAX, për sa kohë që produktet përfundimtare dorëzohen në formatet e përshtatshme për AK.

Përgjigja II: Kërkesa për licencë AutoCAD me minimum 3 përdorues është një kërkesë e justifikueshme dhe e përcaktuar për të siguruar standardizimin, përputhshmërinë dhe cilësinë e dokumenteve të dorëzuara. Përdorimi i një licence me 3 përdorues siguron që OE të ketë kapacitetin e mjaftueshëm për të realizuar projektet në mënyrë të koordinuar dhe në afate kohore me të shpejta. Projektet e parapara me këtë kontratë përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet disa ekspertëve si arkitektët, inxhinierët e strukturave, elektrikes, hidros dhe të tjerë, të cilët duhet të punojnë paralelisht në të njëjtat projekte. Një licencë me minimum 3 përdorues siguron që OE-ja ka burime të mjaftueshme për të mundësuar punën paralele të disa profesionistëve në të njëjtin projekt, duke rritur efikasitetin dhe duke respektuar afatet kohore. AK nuk e përjashton përdorimin e softuerëve të tjerë gjatë procesit të përpunimit, për sa kohë që produktet përfundimtare dorëzohen në formate të përshtatshme për AK. Pretendimi i OE vlerësohet si pjesërisht i bazuar, përkatësisht mund të pranohen edhe softuerët tjerë me licencë valide që kryejnë funksionin e njëjtë me AUTOCAD siç janë ARCHICAD, REVIT ose 3Ds MAX.

Përgjigja III: Licenca Profesionale B1 është një kërkesë e justifikueshme dhe e përcaktuar për të siguruar që operatorët ekonomikë të jenë të kualifikuar për trajtimin e çështjeve të trashëgimisë kulturore. Kontrata në fjalë përfshinë projekte për rinovime të objekteve të trashëgimisë kulturore, ku kërkohet që ndërhyrjet të kryhen në përputhje me rregulloret e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS Licenca B1 është kërkesë e domosdoshme për të garantuar që çdo ndërhyrje të kryhet nga OE të licencuar, me njohuri të nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Përdorimi i licencës B1 siguron që operatorët ekonomikë të kenë njohuritë e duhura për të kryer analiza të detajuara të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe për të projektuar ndërhyrjet në të në mënyrë profesionale. Pretendimi i OE mund të cilësohet si pjesërisht i bazuar pasi që edhe inxhinierit të certifikuar të kërkuar të kapacitet profesional në FDT mund ta kryejnë këtë rol në fazën e hartimit të projektit.

Përgjigja IV: Kërkesa për softuerët për akustikë është një kërkesë e arsyeshme, bazuar në natyrën dhe paramasën e projektit. Në kuadër të paramasës së aktivitetit të prokurimit është paraparë edhe hartimi i analizave akustike dhe ndikimit të zhurmave në objekte investive. Për projektet që përfshijnë ndërtime të larta, rinovime të ndërtesave publike, rregullime të partiturës

urbane dhe ambiente të brendshme, është e domosdoshme që të sigurohet përputhshmëria me standardet ndërkombëtare për komoditetin akustik dhe mbrojtjen nga zhurma. Përdorimi i softuerëve si CATT-Acoustic ose alternativave të ngjashme garanton që llogaritjet dhe analizat akustike të kryhen me saktësi të lartë. AK nuk e ka përjashtuar përdorimin e softuerëve të tjerë as ne dosjen e tenderit, për sa kohe që analizat e bëra përmbushin standardet teknike të kërkuara. Pretendimi i OE refuzohet si i pabazuar, kërkesa për softuerë për akustikë është e arsyeshme për të garantuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për akustikë dhe cilësinë e projekteve të dorëzuara. Siç është cekur edhe ne kërkesën ne FDT mund të pranohen edhe softuerë tjerë të ngjashëm me licence valide.

Përgjigja V: Kërkesa për përdorimin e pajisjeve gjeodezike të avancuara është e arsyeshme dhe e justifikueshme për natyrën dhe përmasat e projektit. Projekti përfshin ndërtime të larta, renovime, rregullime të hapësirave urbane dhe rurale, renovimin e objekteve ekzistuese dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, Infrastrukturë rrugore me instalime përcjellëse. Përdorimi i pajisjeve të avancuara si GNSS RTK, Total Station dhe LIDAR siguron saktësinë e nevojshme për krijimin e stacioneve precize dhe dokumentimin e saktë të terrenit. Gjithashtu përdorimi i këtyre pajisjeve të kërkuara mundëson edhe kryerjen e punëve të parapara brenda afateve kohore të përcaktuara.

Ne dosjen e tenderit janë kërkuar dy (2) gjeodetë dhe jo vetëm një. Autoriteti Kontraktues me FDT kërkon ekspertët kryesorë për fushat e inxhinierisë, por që zakonisht OE kanë staf tjetër teknik që mund të përdorin mjetet e caktuara për kryerjen e punëve të parapara me kontratë. Pretendimi i OE refuzohet si i pabazuar, kërkesat për pajisje të avancuara janë të justifikuara për të garantuar saktësinë, cilësinë, efikasitetin në aspektin kohor dhe përputhshmërinë me kërkesat teknike të projektit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Eng Idea SH.P.K.” ne ankesën Nr. 0269/2025 janë parashtruar si në vijim:

AK, komuna e Suharekës me date 12.03.2025 ka përgatitur dosjen për nevoja të shërbimeve profesionale të procedurës së prokurimit me titull: Hartimi dhe Revidimi i Projekteve Kapitale me numër prokurim 624-25-1794-2-2-1. Ne, ndërmarrja Eng Idea shpk e themeluar ne vitin 2010 kemi zhvilluar aktivitetin tone vetëm ne shërbime profesionale Projektim, Mbikëqyrje dhe konsulentë profesionale ne fushën e arkitekturës e ndërtimtarisë. Për 15 vite ne kemi punësuar eksperte dhe inxh. te fushave te inxhinierisë duke realizuar Hartim te projekteve te natyrave te ndryshme dhe shume te rëndësishëm për shume institucione ne Republikën e Kosove e me gjere përfshi projekte mjaft te rëndësishme edhe për vete AK-ne Komunën e Suharekës. Kjo procedure e prokurimit është analizuar me shume kujdes, nga e cila analize rezulton se kërkesat e paraqitura ne këtë dosje janë ne shperputhje me qëllimin e procedurës si tërësi e ne veçanti bene përjashtimin nga konkurrenca pjesën dërmuese te ndërmarrjeve projektuese përfshi ndërmarrjen tone.

Do t'i paraqesim shqetësimet tona dhe pikat për te cilat ne vlerësojmë se janë kërkesa me qellim te eliminimit të konkurrencës apo favorizimi i drejtpërdrejtë te vetëm një Operatori ekonomik që

posedon stafin, paisjet dhe softwerët e kërkuar ne këtë dosje.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 Kërkesa 2 -1.14. OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier apo bachelor të arkitekturës, të trajnuar, certifikuar për përdorimin e softuerit AUTOCAD. Në këtë pikë, kërkohet që OE të dëshmojë se ka një inxhinier apo bachelor të arkitekturës, i trajnuar dhe i certifikuar për përdorimin e softuerit AutoCAD. Kërkesa kaq specifike është diskriminuese sepse nuk ka arsye të domosdoshme për të kufizuar përdorimin e programeve të projektimit vetëm në AutoCAD, kur dihet se tani me ka me qindra programe për vizatim dhe projektim në fushën e arkitekturës. Puna e arkitekturës mund të realizohet me një gamë të gjerë softuerësh të njohur dhe të përdorur gjerësisht, si ArchiCAD, Revit, SketchUp etj. Kërkesa për certifikim të veçantë vetëm për AutoCAD, kufizon mundësitë e ofertuesve dhe krijon një barrierë të panevojshme për ata që përdorin softuer të tjerë të njohur dhe të pranueshëm në industrinë e arkitekturës. Kërkojmë nga OSHP, të marr vendim për heqjen e kërkesës sepse është kërkesë kufizuese, diskriminuese dhe orientuese për OE të caktuar. Në vendin tonë ka një numër shumë të kufizuar të individëve që certifikohen apo kanë një certifikatë të tillë, sepse në programet studimore sot në fushën e arkitekturës të gjithë arkitektet kanë pasur provime në programet AutoCad, Arch Cad, 3d SmaX etj, andaj në asnjë formë nuk mund të konsiderohet një certifikim për periudha të shkurtër kohore me i vlefshëm se një program studimor semestral apo vjetor. Pra, një kufizim dhe kërkesë e tillë është plotësisht e panevojshme dhe diskriminuese me qëllim të eliminimit të konkurrencës apo favorizimit të ndonjë OE të caktuar.!

Kërkesa 3 - Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon softvverin - Auto Cad softuare (Nga Autodesk) me licencë valide (Architecture Engineering & Construction Collection), me minimum 3 përdorues të autorizuar. Në lidhje me kërkesën 3 të dokumenteve të tenderit, ku kërkohet që operatori ekonomik të dëshmojë se posedon softuerin AutoCAD (nga Autodesk) me licencë valide (Architecture Engineering & Construction Collection) dhe minimum 3 përdorues të autorizuar, është kërkesë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e LPP-se sepse favorizon drejtpërdrejtë prodhues të caktuar (në këtë rast AUTO DESKUN) duke diskriminuar prodhues të tjerë. Siç dihet, ka shumë programe me karakteristika plotësisht të ngjashme apo edhe me cilësore të tjera që mund të përdoren për projektimin arkitektonik dhe inxhinierik, si BricsCad, ArchiCAD, Revid etj., të cilat gjithashtu janë të përdorura gjerësisht dhe të njohura për industrinë inxhinierike. Mund të kalkulojnë se në asnjë formë, vetëm AutoCAD-i specifikisht të lidhet me kërkesat me realizimin e detyrave të projektit? Në vendimin e AK ku kërkesa është konsideruar pjesërisht e bazuar AK prapë nuk e ka përfshirë programin BricsCad në kërkesën e dosjes por e ka anashkaluar qëllimshëm për të kufizuar konkurrencën. Brics Cad është programi më i ngjashëm se të tjetër me Auto Cad. Po ashtu, kërkesa për minimum 3 përdorues të autorizuar krijon barrierë të qëllimshme për operatorët ekonomikë që mund të përdorin versionet e softuerëve të tjerë, të cilët mund të kenë po aq efikasitet (apo të jenë edhe më efikase) në realizimin e projektit e po ashtu komunikojnë edhe me Auto Cad pa asnjë kufizim (në cofte se AK-se i duhet leximi i projektit me AutoCad)! Për më tepër asnjë të drejtë nuk ka AK - të kërkojë nga OE, të kenë licence për Softëer Auto Cad kur vete autoriteti nuk posedon një të tillë!

Kërkojmë nga AK kërkesën për softëer te zgjeroj edhe për prodhues te tjerë përfshi Brics Cad-in duke mundësuar aplikimin e OE -ve qe punojnë me programe te tjera te ngjashme, po ashtu kufizimi për tre përdorues duhet te largohet sepse ka alternativa te tjera te mundshme ne rast te volumit te madh te detyrave për AK-ne. (shembull mund te punohet me tre ndërrime).

Kërkesa 6 - Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon softverve për Akustike, si CATT-Acoustic apo te ngjashëm. Pas analizimit të dokumenteve të tenderit, kemi vërejtur se në paramasë dhe paralogari nuk është parashikuar asnjë punë që lidhet drejtpërdrejt me akustikën. Kjo krijon një paqartësi, pasi kërkesa për softuer të tillë, si CATT-Acoustic, ose të ngjashëm, duket të jetë kërkesë jashtë kuadrit të nevojave të kësaj procedure te prokurimit. Kjo krijon kufizim dhe eshte ne kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, duke kufizuar konkurrencën dhe duke favorizuar operatorët që kanë- posedojnë softuerin e specifikuar! Duke marrë parasysh se në paramasë dhe paralogari nuk është përmendur akustika si pjesë e detyrave të projektit, kërkojmë heqjen e plote te kësaj kërkesë për softuer të akustikes që të përputhet me kërkesat reale të projektit dhe të mos krijojë barrierë te panevojshme për operatorët ekonomikë që mund të kenë mundësi të përdorin kalkulimet akustike ti bëjnë llogari me metodat e llogaritjeve te bëra kohe me pare - ne mënyrë empirike e cila është shume e thjeshte.

Kërkesa 7 - OE duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit (matje precize dhe profesionale gjeodezike) Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Në lidhje me listën e pajisjeve të kërkuara për projektin (të detajuara në tabelën që keni paraqitur), kërkojmë heqjen e kërkesës për këto pajisje specifike dhe nevojën e përdorimit të tyre ne këtë dosje!

Kërkesa për pajisje të tilla të avancuara si Set GPS Baze+Rover, GPS GNSS RTK, Total Station, Dronë me sistem LIDAR dhe skanera 3D, ka specifika të larta dhe krijon barrierë për operatorët ekonomikë - kufizon konkurrencën që mund të kenë pajisje të ngjashme me specifika të tjera te cilat nuk dëmtojnë performancën ne asnjë mënyrë. Për, natyrën projekteve që ka nevojë AK është e pashpjegueshme dhe aspak e nevojshme pajisje me këto karakteristika të caktuara dhe nuk lidhen me realizimin e detyrave të tenderit?, përveç se ngushtojnë dhe kufizojnë konkurrencën apo drejtpërdrejtë favorizojnë OE te caktuar (apo paracaktuar!). Përderisa ne dosjen e tenderit është kërkuar vetëm dy inxhinier te gjeodezisë, si është e mundur që ne kuadër te paisjeve

Aneksi 7 janë kërkuar 9 paisje për kryerjen e shërbimeve gjeodezike, qe ne realitet për shërbime te projektimit do te jete mese e mjaftueshme një stacion total dhe GPS me saktësi standarde për fushën e projektimit-natyrën e procedurës se prokurimit. Kërkojmë, nga OSHP te shqyrtoj me seriozitet këto kërkesa, te beje reduktimin e gjithë këtyre paisjeve gjeodezike, te racionalizoj kërkesën duke mos bere diskriminim për OE që kane aftësi e paisje te mjaftueshme që përmbushin kërkesat e procedurës se prokurimit - matjeve dhe incizimeve për nevoja te projektimit?

Kërkesa për pajisje të tilla të avancuara kufizon konkurrencën dhe ndikon drejtpërdrejtë në mundësinë që operatorët ekonomikë të ofrojnë alternativat e duhura për realizimin e projektit, duke siguruar që kërkesa për pajisje të jetë e arsyeshme dhe në përputhje me parimet e LPP-së për konkurrencë të ndershme dhe barazi. Sqarim: kufizimi i kërkesave në certifikime është plotësisht tendencioz dhe i qëllimshëm duke anashkaluar në tërësi të drejtat ligjore për zhvillim të aktivitetit profesional për Arkitektet, inxhinieret e të gjitha profileve, gjeodetet etj. të cilët posedojnë licenca profesionale nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës.

Për këto arsye këto certifikime dhe Licencat e kërkuar janë kufizim i drejtpërdrejtë duke i pamundësuar dhe mohuar inxhinierëve të drejtën themelore të zhvillimit të aktivitetit të tyre profesional në fushën përkatëse, përgatitur me diplome universitare e po ashtu Licence nga Institucionet shtetërore.

Kërkojmë nga OSHP që secila pike e kërkesave të trajtohet në aspektin profesional, dhe në përputhje me natyrën e procedurës së prokurimit dhe në përputhje me LPP-ne, si dhe në rast të mbajtjes së seancës të Panelit shqyrtues në duam të marrim pjesë me qëllim të argumentimit të të drejtave profesionale të njohura me ligj. Këto të drejta janë duke u mohuar nga AK me kërkesa të paarsyeshme dhe të panevojshme e diskriminuese dhe për të njëjtën do t'i drejtohem organëve gjegjëse - KRPP-se dhe APK-se.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0269/2025, i cili është dorëzuar me datë 06.15.2025.

Lidhur me pretendimet e OE "Eng Idea" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0269 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin e pare ankimor: Përdorimi i AutoCAD-it në fushën e projektimit padyshim që është i përhapur dhe i standardizuar në shumë institucione dhe kompani, por ai nuk është i vetmi softëer profesional i pranuar në industrinë e projektimit të projekteve kapitale. Softëerë të tjerë si Archicad, Revit, BricsCad, SketchUp etj. janë po ashtu të pranuar gjerësisht në praktikën bashkëkohore të arkitekturës dhe inxhinierisë. Kriteri i kërkuar për certifikim specifik vetëm për AutoCAD mund të rezultojë në favorizim të operatorëve të caktuar apo në eliminim të padrejtë të konkurrencës, sidomos nëse nuk arsyetohet me domosdoshmëri teknike specifike për projektin. Nëse qëllimi është të sigurohet që stafi profesional të ketë aftësi për përdorimin e softëerëve për projektim, kriteri mund të formulohet në mënyrë më gjithëpërfshirëse, duke përmendur se personi përgjegjës duhet të ketë aftësi në përdorimin e një softweri të specializuar

për projektim arkitektonik, pa përmendur një emërtim specifik.

Në mungesë të një justifikimi teknik për përdorimin ekskluziv të AutoCAD-it, një kërkesë e tillë mund të konsiderohet diskriminuese dhe në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilat kërkojnë që kriteret të përpilohen në mënyrë që të mos favorizojnë ose diskriminojnë operatorët ekonomikë. AK nuk duhet të përjashtoj përdorimin e softwereve tjerë si Archicad, Revit, BricsCad, SketchUp etj. derisa projektet përfundimtare dorëzohen në formatet e përshtatshme dhe sipas kërkesës së AK. Konsideroj që kriteri duhet riformuluar në mënyrë më gjithëpërfshirëse, duke lejuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë aftësinë për përdorimin e të paktën një softveri të njohur për projektim arkitektonik, si Archicad, Revit, BricsCad, SketchUp etj. Në lidhje me pretendimet ankimore të Ankuesit që kanë të bëjë me Kërkesa 2. 1.14, eksperti teknik shqyrtues mendon se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1. Kërkesat e AK janë në kundërshtim me nenin 7 par.6 pika (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; dhe (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik të LPP-së. Duke iu referuar pretendimit ankimor të sipër përmendur, mendimi i ekspertit teknik është se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e dytë ankimor: Kërkesa 3 - Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon softuerin - Auto Cad software (Nga Autodesk) me licence valide (Architecture Engineering & Construction Collection), me minimum 3 përdorues të autorizuar. Në lidhje me kërkesën 3 të dokumenteve të tenderit, ku kërkohet që operatori ekonomik të dëshmojë se posedon softuerin AutoCAD (nga Autodesk) me licencë të vlefshme (Architecture Engineering & Construction Collection) dhe minimum 3 performues të autorizuar, është kërkesë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e LPP-së sepse favorizon drejtpërdrejtë prodhues të caktuar (në këtë rast Auto DESKUN) duke diskriminuar prodhues të tjerë. Siç dihet, ka shumë programe me karakteristika plotësisht të ngjashme apo edhe me cilësore të tjera që mund të përdoren për projektimin arkitektonik dhe inxhinierik, si BricsCad, ArchiCAD, Revit etj., të cilat gjithashtu janë të përdorura gjerësisht dhe të njohura për industrinë inxhinierike. Mund të konkludojmë se në asnjë formë, vetëm AutoCAD-i specifikisht të lidhet me kërkesat me realizimin e detyrave të projektit? Në vendimin e AK ku kërkesa është konsideruar pjesërisht e bazuar AK prapë nuk e ka përfshirë programin BricsCad në kërkesën e dosjes por e ka anashkaluar qëllimshëm për të kufizuar konkurrencën. Brics Cad është programi më i ngjashëm me Auto Cad. Po ashtu, kërkesa për minimum 3 performues të autorizuar krijon barrierë të qëllimshme për operatorët ekonomikë që mund të përdorin versionet e softwereve të përmendur, të cilët mund të kenë po aq efikasitet (apo të jenë edhe më efikas) në realizimin e projektit e po ashtu komunikojnë edhe me Auto Cad pa asnjë kufizim (në qoftë se AK-se i duhet leximi i projektit me AutoCad)! Për më tepër asnjë të drejtë nuk ka AK – të kërkojë që OE, të kenë licence për Software Auto Cad kur vetë autoriteti nuk posedon një të tillë!

Ekspertja teknike pas analizës së kësaj kërkesë, thekson: Kërkesa e AK që ekskluzivisht të përdoret softveri AutoCAD i licencuar nga Autodesk përbën një shkelje të parimeve të

neutralitetit teknik dhe konkurrencës së ndershme, të cilat janë të garantuara me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në rastet kur natyra e punës nuk kërkon domosdoshmërisht përdorimin e një produkti specifik (si p.sh. AutoCAD), autoriteti kontraktues nuk duhet të përmend emra tregtarë apo të kushtëzojë performancën me prodhues specifikë të softëerëve. Softëerë si: ArchiCAD, Revit, BricsCAD AllPlan etj. janë programe projektimi të njohura ndërkombëtarisht dhe ofrojnë funksionalitet të krahasueshëm me AutoCAD. Për më tepër, shumica e tyre përputhen në formatet (DËG/PDF) dhe dorëzohen sipas kërkesës së AK. Kërkesa për 3 përdorues të autorizuar për një softëer të caktuar është jo-proporcionale dhe vendos barrierë të panevojshme për operatorët ekonomikë që operojnë me struktura më të vogla por profesionalisht të kualifikuara. Rekomandoj që Kërkesa 3 të modifikohet në mënyrë që :Të lejohet çdo softëer i njohur ndërkombëtarisht për projektim arkitektonik, deri sa dëshmohet zotërimi dhe funksionaliteti i tij në përputhje me kërkesat e projektit, kërkesa për minimum 3 përdorues të autorizuar, të zëvendësohet me një kriter më të arsyeshëm që kërkon staf të aftë për përdorimin e një softweri të përshtatshëm për projektim. Duke iu referuar pretendimit ankimor të sipër përmendur, mendimi i ekspertës teknike është se pretendimi ankimor i Ankuesit është i bazuar. Përgjigje në pretendimin e trete ankimor: Kërkesa 6 - Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon softëer Për Akustike, si CATT-Acoustic apo të ngjashme.

Pas analizimit të dokumenteve të tenderit, kemi vërejtur se në paramasë dhe parallogari nuk është parashikuar asnjë punë që lidhet drejtpërdrejt me akustikën. Kjo krijon një paqartësi, pasi kërkesa për softuer të tillë, si CATT-Acoustic, ose të ngjashëm, duket të jete kërkesë jashtë kuadrit të nevojave të kësaj procedure të prokurimit. Kjo krijon kufizim dhe është në Kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, duke kufizuar konkurrencën dhe duke favorizuar operatorët që kanë-posedojnë softuerin e specifikuar. Duke marrë parasysh se në paramasë dhe parallogari nuk është përmendur akustika si pjesë e detyrave të projektit, kërkojmë heqjen e plote të kësaj kërkesë për softuer të akustikës që të përputhet me kërkesat reale të projektit dhe të mos krijojë barrierë të panevojshme për operatorët ekonomikë që mund të kenë mundësi të përdorin kalkulimet akustike të bëjnë llogari me metodat e llogaritjeve të bëra kohe me pare – në mënyrë empirike e cila është shume e thjeshte.

Ekspertja teknike pas shqyrtimit të dosjes së tenderit dhe analizimit të përmbajtjes së paramasës dhe parallogarisë, konstaton se: Në dokumentacionin teknik të përfshirë në dosjen e tenderit nuk janë parashikuar punë specifike që lidhen me: projektimin ose kontrollin e izolimit akustik, Si rrjedhojë, nuk ekziston justifikim teknik që e bën të domosdoshëm përdorimin e një softweri të specializuar për akustikë në këtë projekt.

Përcaktimi për posedimin e një softweri specifik ose të ngjashëm për akustikë, kur nuk është pjesë e objektit real të projektit, bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe krijon një pengesë për operatorët që nuk e zotërojnë një softëer të tillë, edhe pse janë në gjendje të ofrojnë projekte të plota e të kualifikuara profesionalisht. Në praktikën inxhinierike, për performancë akustike, projektuesit mund të mbështeten në: standardet e njohura për zgjidhje ndërtimore akustike me kalkulime empirike. Rekomandoj që kërkesa të rishqyrtohet dhe modifikohet në përshkrim me të përgjithësuar. Duke iu referuar pretendimit ankimor të sipër përmendur, mendimi i ekspertës teknike është se pretendimi ankimor i Ankuesit është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e trete ankimor: Kërkesa 7 - OE duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit (matje precize dhe profesionale gjeodezike) Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Në lidhje me listën e paisjeve të kërkuara për projektin (të detajuara në tabelën që keni paraqitur), kërkojmë heqjen e kërkesës për këto pajisje specifike dhe nevojën e performimit të tyre në këtë dosje! Kërkesa për pajisje të tilla të avancuara si Set GPS Baze+Rover, GPS GNSS RTK, Total Station, Dronë me sistem LIDAR dhe skanera 3D, ka specifika të larta dhe krijon barrierë për operatorët ekonomik — kufizon konkurrencën që mund të kenë paisje të ngjashme me specifika të tjera të cilat nuk dëmtojnë performancën në asnjë mënyrë. Për natyrën e projekteve që ka nevojë AK është e pashpjegueshme dhe aspak e nevojshme pajisje me këto karakteristika të caktuar dhe nuk lidhen me realizimin e detyrave të tenderit? përveç se ngushtojnë dhe kufizojnë konkurrencën apo drejtpërdrejtë e favorizojnë operatorin OE të caktuar (apo PARAKAKTUAR!). Përderisa në dosjen e tenderit është kërkuar vetëm dy inxhinier të gjeodezisë, si është e mundur që në kuadër të paisjeve Aneksi 7 janë kërkuar 9 paisje për kryerjen e shërbimeve gjeodezike, që në realitet për shërbime të projektimit do të jetë mese e mjaftueshme një stacion total dhe GPS me saktësi standarde për fushën e projektimit-natyrën e procedurës së prokurimit. Kërkojmë, nga OSHP të shqyrtojë me seriozitet këto kërkesa, të bëjë reduktimin e gjitha këtyre paisjeve gjeodezike, të racionalizoj kërkesën dukemos diskriminuar OE që kanë aftësi e paisje të mjaftueshme të përmbushin kërkesat e procedurës së prokurimit — matjeve dhe incizimeve për nevojat e projektimit. Kërkesa për paisje të tilla të avancuara kufizon konkurrencën dhe ndikon drejtpërdrejtë në mundësinë që operatorët ekonomik të ofrojnë alternativat e duhura për realizimin e projektit, duke siguruar që kërkesa për paisje të jetë e arsyeshme dhe në përputhje me parimet e LPP-së për konkurrencë të ndershme dhe barazi. Për këto arsye këto certifikime dhe Licencat e kërkuar janë kufizim i drejtpërdrejtë duke i pamundësuar dhe mohuar inxhinierëve të drejtën themelore të zhvillimit të aktivitetit të tyre profesional në fushën përkatëse, përgatitur me diplomë univerzitare e po ashtu Licencë nga Institucionet shtetërore. Kërkojmë nga OSHP që secila pike e kërkesave të trajtohet në aspektin profesional, dhe në përputhje me natyrën e procedurës së prokurimit dhe në përputhje me LPP-ne, si dhe në rast të mbajtjes së seancës të Panelit shqyrtues në duam të marrim pjesë me qëllim të argumentimit të të drejtave profesionale të njohura me ligj. Këto të drejta janë duke u mohuar nga AK me kërkesa të paarsyeshme dhe të panevojshme e diskriminuese dhe për të njëjtën do t'i drejtohem organëve gjegjëse – KRPP-se dhe APK-se.

Pas shqyrtimit të dokumenteve të tenderit, përfshirë Aneksin 7, si dhe natyrën e projektit “hartimi dhe revidimi i projekteve kapitale”, ekspertja teknike konstaton: Projekti në fjalë është i natyrës projektuese jo ekzekutuese apo topografike në terren në shkallë të gjerë që kërkon saktësi të lartë milimetrike. Për këtë qëllim, paisjet bazike si një Total Station dhe një GPS standard për gjeodezi janë të mjaftueshme për të mbledhur të dhënat fillestare për hartimin e projektit, duke e bërë kërkesën për paisje të specializuara dhe të kushtueshme si LIDAR, RTK GPS me bazë+rover, apo dronë industrial, të paarsyeshme dhe joproporcionale me objektin e kontratës. Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë kërkon që kriteret teknike të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e kontratës dhe të mos pengojnë konkurrencën në mënyrë të pajustifikuar. Duke kërkuar

lista të pajisjeve të avancuara pa arsyetim të dokumentuar teknik për nevojën e tyre, AK shkel këtë parim, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve me kapacitete reale, por që përdorin mjete më ekonomike dhe gjithsesi profesionale. Kërkesa për këto paisje nuk është e justifikuar teknikisht në dokumentacionin e tenderit – mungon relacioni teknik apo raporti i nevojës që shpjegon përse janë të nevojshme të gjitha këto pajisje. Duke u bazuar në vlerësimin e mësipërm, rekomandoj që: Kërkesa për paisjet specifike në Aneksin 7 të rishqyrtohet dhe reduktohet, në përputhje me objektin real të kontratës, Kërkesa të formulohet në mënyrë funksionale dhe jo specifike për marka apo teknologji të caktuara, të përfshihet mundësia për përdorimin e paisjeve ekuivalente, me përshkrim të performancës së kërkuar. Duke iu referuar pretendimit ankimor të sipër përmendur mendimi i ekspertës teknike është se pretendimi ankimore i Ankuesit është pjesërisht i bazuar.

Duke u mbështetur në sqarimet e lartpërmendura nga eksperti teknike, eksperti shqyrtues mendon që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues është e bazuar, Autoriteti Kontraktues ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 1, 6, 7 par.6 pika (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; dhe (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik të LPP-së të LPP-së për shkak të kritereve diskriminuese dhe rekomandojmë që AK të bëjë shtyrjen e afatit për dorëzimin e ofertave në pajtim me dispozitat e LPP-së, duke bërë paraprakisht korrigjimet e dosjes së tenderit – kritereve të dhëna sipas përgjigjeve në Pretendimet ankimore të këtij raporti.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur në tërësi besimin ekspertit shqyrtues sa i përket përgjigjeve në këto pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Po ashtu, duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit.

Arsyeja pse PSH nuk e përkrah në tërësi raportin e ekspertit shqyrtues dhe teknik është për faktin se në të gjitha pretendimet ankimore përgjigje që ka dhene ekspertja teknike e cila në bazë të përgjigjeve shumë lehtë mund të konstatohet se e njëjta mund të mos i ketë pasur të gjitha dokumentacionet në dispozicion dhe të gjitha veprimet e Autoritetit Kontraktues Komuna e Suharekës. Me çrast kërkesën për ri-shqyrtim të OE ankues të bërë me dt. 01.04.2025, autoriteti kontraktues e kualifikon nxjerrë vendim me dt. 04.04.2025, e cila e bënë aprovimin e kërkesës për ri-shqyrtim si pjesërisht të bazuar dhe me dt. 07.04.2025 i ndryshon kërkesat e DT përmes Formularit për korrigjim të Gabimeve (B54) dhe ri-publikon Dosjen e Tenderit me kriteret të përmirësuar. Veprim ky i AK të cilin Paneli Shqyrtues e vlerëson si shumë profesional, ashtu sikurse edhe përgjigjet e AK i kualifikon si mjaftë të bazuara dhe në harmoni edhe me nenit 51.3 të LPP. Lidhur me Pajisjet e kërkuara, AK ka lejuar në Dosje të tenderit, citat: *“Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët”*.

Andaj, PSH këto pretendime i kualifikon si pjesërisht të bazuara por për të cilat AK ka bërë përmirësimet, kështu që, PSH i lejon AK të vazhdoj tutje me këtë aktivitet të prokurimit.

Si rrjedhojë, Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit, ka vendosur që të lë në fuqi Dosjen e Tenderit të korrigjuar nga AK me dt. 07.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi dhe Revidimi i Projekteve Kapitale” me nr. të prokurimit 624-25-1794-2-2-1, dhe AK të vazhdoj tutje me aktivitetin e prokurimit.

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet te jenë padrejtësisht te rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e produkteve që plotësojnë nevojat adekuate të tyre, si dhe pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme te cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. Andaj, AK është përgjegjëse edhe për hartim të DT, sipas nenit 27 dhe 28 të LPP.

Paneli Shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjesërishtëm të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4

të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - ENG IDEA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: